

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



e-buletini **no.13**

Gusht - Dhjetor 2016

www.ruralnet.mk

PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë

“Kosta Veselinov” 3a,
1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk



Në këtë numër...



1. Shoqata e artistëve artizanë ARTI KRAFT	3
2. Aktivitete të realizuar të Fondacionit Elena Luka	4
3. Projekti “EnerGain”	5
4. Instituti për Zhvillim të Komunitetit	5
5. Koalicioni Rural - Kumanovë	6
6. Aktivitete të Qendrës Ndërkombëtare për Art dhe Zhvillim të Qëndrueshëm “Art Point - Gumno”	7
7. Ditët e bletarisë maqedonase	9
8. Thirrje e tretë e Rrjetit për Zhvillim Rural për mbështetje të iniciativave të projektit	10
9. Zhvillohet Kuvendi i Përgjithshëm i Rrjetit për Zhvillim Rural	13
10. GLA – nga iniciativa lokale në koncept prijës për zhvillim të komuniteteve rurale	14
11. Tryezë e rrumbullakët: “Ndikimi i ndryshimeve klimatike mbi bletarinë”	16
12. Si të zvogëloni efektet negative nga stresi i ngrohjes tek bagëtitë? ...	18
13. Prezantimi i rezultateve të zbatimit të masave për adaptimi ne blegtorisë ndaj ndryshimeve klimatike	19
14. Mbyllje e projektit të USAID për adaptim të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike	20
15. Organizohet Info Ditë për IPARD 2 – Masa 302	21
16. Shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale – 15 tetor	22
17. Panairi i tretë rajonal i vitit të ri të produkteve lokale në Nikshiq	23
18. PREPARE Mbledhja 2016 dhe Kuvendi i Përgjithshëm u mbajti në Voskopojë, Shqipëri	24
19. Konferencë ndërkombëtare për përdorimin e masës për ndihmë teknike në përgatitjen e zbatimit të LEADER	25
20. Forumi rajonal “Nga ekonomi të qëndrueshme në shoqëri të qëndrueshme”	26



1

Shoqata e artistëve artizanë

ARTI KRAFT

Anëtarët e Shoqatës së Artistëve Artizanë Arti Kraft, me produktet e tyre të përpunuar me shkathtësi, në mënyrë aktive marrin pjesë në shumë panairë dhe manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare si:

- Ditët e Tresha – ngjarje që për herën e trembëdhjetë ishte organizuar në Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë, në të cilën kryetari i Arti Kraft, Gordana Mitrovska, ka fituar vendin e tretë për suvenir më të mirë;
- Takim me artizanë në Ulqin, Mal të Zi;
- Ditë të Trashëgimisë Kulturore në Prishtinë;
- Panair ndërkombëtar të artizaneve të vjetra në Uzhinca, Serbi, i quajtur “Artizani është i artë”;
- Panair i vitit të ri të produkteve lokale në Nikshiq, Mal të Zi;
- Etno ditë në Pehçevë me rastin e Paviloiden;
- Pazar i vitit të ri të produkteve të artizanëve në sheshin Filip i Dytë në Shkup.



Me qëllim të shënimit të 25 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, nën patronazhin e Qytetit të Shkupit dhe në organizim të shoqatës së artistëve artizanë “Arti Kraft”, më 6 dhe 7 shtator 2016, në Muzeun e Maqedonisë dhe Suli An në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, ishte zhvilluar një revu të veshjeve kombëtare të rajonit të Shkupit nga koleksioni privat i Mr. Dsotana Karagjozovska Stankovska dhe anëtarë të Arti Kraft. Një numër i madh i adhuruesve dhe mbështetëse të zhvillimit dhe ruajtjes së pasurisë së veshjeve popullore dhe artizaneve, kanë marrë pjesë në këtë manifestim unik dhe ekspozitë të veshjeve popullore maqedonase.

Në bashkëpunim me Fondacionin për Shërbim Ndërmarrës për të Rinj, Arti Kraft, ka organizuar punëtori për qepje me dore të veshjeve popullore dhe përpunim të suvenirëve, të synuar për të rinjtë në komunën e Staro Nagoriçane, Kumanovë. Projekti ishte financuar nga Bashkimi Evropian.



Shoqata është iniciator për themelimin e rrjetit kombëtar të artistëve artizanë-mjeshtër të artizaneve të vjetra.





2

Aktivitete të realizuar të Fondacionit Elena Luka

Aktivitete për mbështetje të sipërmarrjes tek të rinjtë

Për të nxitur krijimtarinë dhe inovacionin e të rinjve, si dhe frymën sipërmarrëse dhe solidaritetin, fondacioni "Elena Luka" në shtator ka hapur një Konkurs për Përpunimin e Skicës për Dizajn të Krijimit për Maturë. Të drejtë pjesëmarrje kanë pasur nxënësit e shkollave të mesme nga gjithë Maqedonia.



Duke marrë parasysh interesit të madh që kanë pasur krijuesit e rinj dhe skicat e shumta të arritura në adresën e fondacionit, ekipi profesional i Elena Luka ka vendosur që përveç tre personave që do të shpërblehen me makina për qepjeje, të jep edhe fletë-falënderime edhe atyre që kanë lënë më shumë përshtypje. Aspekti humanitar i këtij konkursi është që dizajnët e skicave të tre personave më të mirë do të përpunohen nga Elena Luka si krijime mature për tre maturante që gjenden në situatë të dobët të nevojës sociale.

*Skica e shpërblyer në Konkurs, Zunka Atanasova, SHMK
Nikolla Karev, Strumicë.*

Aktivitete për mbështetje të mundësive të barabarta në arsim

Në kuadër të projektit "Planifiko ardhmërinë tuaj", Fondacioni Elena Luka ka ndarë pesë bursa për pesë studente nga komunat vijuese: LLozovë, Mogilla, Centar Zhupa, Çashka dhe Shkup. Të drejtë për bursë kanë realizuar kandidatët që kanë plotësuar kriteret që janë dhënë në konkursin e publikuar dhe gjatë radhitjes së kandidatëve janë marrë parasysh suksesi i nxënësve dhe të ardhurat mujore në familjen. Përndryshe, Fondacioni vetëm më ka dhënë pesë bursa për pesë nxënëse të shkollës së mesme në komunat e njëjtë.



*Firmosen marrëveshjet për bursa për arsimin e lartë,
28.10.2016*

Edukime për të drejta të njeriut

Në kuadër të projektit "Parandalimi i dhunës së bazuar në gjini", Fondacioni Elena Luka ka zbatuar rreth 20 punëtori për të drejta të njeriut me nxënës të shkollave fillore, të rinj, si dhe gra dhe nëna. Punëtoritë ishin në temat vijuese: barazia gjinore, jo-diskriminimi dhe dhuna e bazuar në gjini. Këto punëtori janë zbatuar në 6 komuna dhe në këto kanë marrë pjesë rreth 400 pjesëmarrës.

Qëllimi i trajnimeve ishte avancimi i barazisë gjinore, ulja dhe parandalimi i diskriminimit dhe parandalimi i dhunës së bazuar në gjini në komunitetet. Qëllimi përfundimtar është krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë.



*Punëtori në temë "Parandalimi i dhunës së bazuar në gjini"
SHMK Gjumnazi Sllavčo Stojmenski, Shtip, 09.12.2016*



3

Projekti “EnerGain”

Projekti “Promovimi i prodhimtarisë së decentralizuar të energjisë nga burime të ripërtërirë të energjisë” të cilin e zbaton Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike – Gjevgjeli dhe Aleanca e Prodhuesve të Energjisë Ekologjike – BG nga Blagoevgrad ka për qëllim të mbështet formimin e qasjes së integruar në rajonin kufitar në fushën e prodhimtarisë së decentralizuar të energjisë nga burime të ripërtërirë dhe prezantimi i zgjidhjeve për efikasitet energjetik. Realizimi i projektit do të stimulojë bizneset lokale dhe do të kontribuojë për optimizim të shpenzimit të plotë të energjisë dhe shpenzimeve. Një prej qëllimeve është të përmirësohet vetëdija dhe rritet interesi i grupit synues dhe aktorëve nga rajoni kufitar për zgjidhje energjetike të decentralizuar dhe shfrytëzim të potencialit nga burime të ripërtërirë të energjisë dhe përfitimet e tyre kryesore: ekologjike; ekonomike (shpenzime të zvogëluar dhe pavarësi energjetike); efikasitet (cilësi të energjisë elektrike dhe qëndrueshmëri); ruajtje të resurseve (me përdorimin e BRE); siguri dhe qetësi. Në këtë drejtim, projekti promovon konceptin, teknologjitë kryesore dhe përfitimet për objektet individuale banesore, objekte afariste dhe publike (komuna, sektori arsimor, institucione, etj.)

Projekti do të realizohet me anë të programit të punës që mes tjerash parashikon edhe informim dhe ngritje të vetëdijes me anë të fushatës “çati diellore” e përbërë nga 6 punëtorë për informim dhe diskutim; përpunim të “Udhëzuesit diellor për investime” i synuar për tre lloje të përdoruesve – amvisëri private, MSP dhe institucione publike; përpunimi i ueb portalit “ErnerGAIN” – ueb faqe edukative me këshilla dhe filma edukativ për përmirësim të resurseve në internet që do të sigurojë përdoruesve potencial informacione dhe këshilla përkatëse për zgjidhje bashkëkohore për shtëpi efikase energjetike dhe ekologjike, institucion afarist ose tjetër publik; trajnime të përbashkëta të për teknik dhe inxhinierë të BRE – ngritja e kapaciteteve, shkëmbim i përvojave dhe njohurive në pjesën e programit për profesionistë dhe ekspertë nga fusha e BRE dhe EE; si dhe e-mësim me anë të programit për trajnim “EnerGAIN”.

E gjithë kjo, kontribuon për përmirësim të kapaciteteve për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe përdorim të qëndrueshëm të resurseve të përbashkëta natyrore.

Projekti është financuar me IPA Programin për Bashkëpunim Ndërkufitar mes Maqedonisë dhe Bullgarisë.

4

Instituti për Zhvillim të Komunitetit

1. Formohet Grupi Lokal i Aksionit “GLA Skardus”

Instituti për Zhvillim të Komunitetit (IZHK), në kuadër të aktiviteteve programore, zbaton aktivitete për mbështetje të zhvillimit rural dhe përmirësim të kushteve për jetë të qytetarëve në mjediset rurale. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me përfaqësues të sektorit publik, sektorit afarist, shoqatave të qytetarëve dhe personave fizik nga komunat Jegunovcë, Tearcë dhe Tetovë kanë nisur me formimin e Grupit Lokal të Aksionit “GLA Skardus”. Qëllimi i GLA Skardus është mobilizimi i potencialeve lokale me anë të organizimit, edukimit dhe mbështetjes për përmirësim të kushteve për jetë dhe zhvillimit të plotë të mjedisit rural në territorin e komunave Jegunovcë dhe Tearcë. Shoqata IZHK ishte në mënyrë aktive e kyçur në formimin e GLA Skardus, si anëtare e organit koordinues dhe gjatë procesit ka siguruar mbështetje administrative dhe mbështetje teknike. Themelues të shoqatës janë: përfaqësues të sektorit publik,



sektorit afarist dhe shoqata të qytetarëve dhe persona fizik nga komunat Jegunovcë, Tearcë dhe Tetovë. Procesi i themelimit të shoqatës është zhvilluar me anë të pjesëmarrjes së përfaqësuesve në tetë punëtorë të mbështetur financiarisht nga projekti i USAID për zgjerimin e bizneseve të vogla.



2. Iniciativa për formimin e Komitetit Kombëtar për Bujqësi Familjare

Shoqata Instituti për Zhvillim të Komunitetit (IZHK) – Tetovë, në partneritet me Rrjetit për Zhvillim Rural dhe Federatën e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë, ka filluar me realizimin e aktiviteteve lidhur me iniciativën për formim të Komitetit Kombëtar për Bujqësi Familjare në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi i iniciativës është të themelohet Komitet Kombëtar që do të identifikojë sidat, do të përfaqësojë bujqësitë familjare në Maqedoni dhe do të synojë themelimin e politikave për mbështetje dhe zhvillim të tyre. Gjatë aktiviteteve, janë parashikuar takime me palë të interesuar, trajnime, punëtori për zhvillim të planit strat-



egjik si dhe zhvillim të Kuvendit të Komitetit Kombëtar për Bujqësi Familjare.

5

Koalicioni Rural - Kumanovë



Nga 1 gushti 2016, Koalicioni Rural – Kumanovë ka filluar me zbatimin e projektit *Ekonomi Tregu dhe Kapacitetet Institucionale* i mbështetur nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Projekti ka për qëllim të përcaktojë lidhjen mes fermerëve dhe kapaciteteve institucionale të vendit që veprojnë në pjesën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, si dhe të përcaktohet shkalla e ndikimit të institucioneve dhe cilësisë së punës së tyre mbi krijimin e ekonomisë tregtare në shtet.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit: Kontrolli dhe mbikëqyrja e punës së institucioneve kyçe në sektorit bujqësor dhe kontributi (jo) i tyre ndaj zhvillimit të ekonomisë së tregut në pjesën e produkteve bujqësore.

Grupi synues: fermerë dhe popullata rurale, si dhe pesë institucionet kyçe që veprojnë në sektorin e bujqësisë: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit (MBPEU), Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë – Manastir (ANZHB), Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (AMBBZHR), Agjencia për Ushqim dhe Veterinë (AUV) dhe Inspektorati Bujqësor Shtetëror.

Në sajë të aktiviteteve të projektit të parashikuar për periudhën gusht 2016 – dhjetor 2016, është realizuar hulumtim desktop dhe në teren për numrin e të punësuarve në pesë institucionet kyçe në sektorin bujqësor, buxhetin me të cilin disponon secila prej institucioneve, korniza ligjore në të cilën ata funksionojnë. Në kuadër të hulumtimit, është përfshirë edhe grupi tjetër synues, gjegjësisht fermerët për të cilët edhe ekzistojnë këto institucione, gjegjësisht njohja e kompetencave dhe përgjegjësi të tyre nga fermerët, perceptimi i tyre cilësor dhe sasior për shërbimet të cilat këto institucione japin, gatishmëria e tyre në kuptim të infrastrukturës, mbulimit me zyra rajonale dhe lokale, etj. Rezultatet e fundit nga hulumtimi janë shqyrtuar në 3 debate edhe atë në Gostivar, Prilep dhe Strugë në të cilën kanë marrë pjesë fermerë dhe përfaqësues nga institucionet duke dhënë vërejtjet e tyre dhe plotësimit që do të përfshihen në dokumentin përfundimtar. Gjithashtu ishte përpunuar një hartë e institucioneve dhe përgjegjësitë e tyre e cila në mënyrë figurative fermerit do të tregojë dhe lehtësojë komunikimin me institucionet dhe njohjen e fushës së tyre të veprimit.



6

Aktivitete të Qendrës Ndërkombëtare për Art dhe Zhvillim të Qëndrueshëm “Art Point - Gumno”

Jubile i 10-të KREMTIMI I PIREUT (28 gusht 2016)

Në festën e Zonjës së Madhe, në Slloeshticë, u zhvilluar manifestimi KREMTIMI I PIREUT – 10 vite nga vdekja dhe 10 vite jetë të përhershme të madhështorit Petre M. Andreevski!

Udhëheqës i programit të manifestimit ishte kënga “Fytyra e fjalëve” si dhe tema qendrore e punimit të doktoraturës së Prof. Vesna Mjsova – Çepishevska që ka zhvilluar fjalimin hyrës për Petre.

Në qendrën artistike, publiku kishte mundësi ekskluzive të ndjek Promovimin Botëror të Revisë së Modës të Përparësive të dizajnuar nga artistja gjermane Gerlinde Pistner. Kjo revie u mbajt për nder të përparës, ajo përparëse e larme e gjyshes, për të cilën Petre M. Andreevski e ka njoftuar atdheun. Modelet ishin vullnetare të APG nga Slloeshtica dhe aktorët nga “Teatri Kombëtar Sllojshticë”.



Pastaj vijoi një shfaqje muzikore me vokalistin e re me emrin artistik Eva Gordon që ka prejardhjen nga Demir Histari dhe ishte pjesë e projektit PERIJA.

“Fjalën Përfundimtare” të manifestimit e kishte “Slojčki Skazaniya” e punuar përrallave të gjyshit Ilija Kočovski (Marko Cepenkov nga Demir Hisari). Kjo premierë njëherë ka shënuar edhe themelimin e “Teatrit Kombëtar Sllojshticë” (shfaqja sot është vendosur në repertorin e teatrit Komedi me titullin “Përrallat e Paraardhësve të Harruar”). Manifestimi ishte pjesërisht e mbështetur nga Ministria e Kulturës së RM-së.



1. Rezidenca artistike “Art Point - Gumno 2016”

Rezidenca artistike në Slloeshticë ka vazhdimësi prej 13 viteve, ndërsa këtë herë u zhvillua në periudhën prej 10 shtator deri më 2 tetor. Më 24 shtator publiku kishte mundësinë të shih veprat e krijuar gjatë kohës së rezidencës dhe drejtpërdrejtë të flet me artistët:

- **Rozi Njuman** nga Kromarti, Skopi. Ajo është piktores, skulptore dhe merret edhe me film. Ligjëron në “Universitetin e Hajlend dhe ishujt” në Invernes. Krijimi i saj është proces që fillon me vizatime dhe fotografi që dalin nga rrethina.
- **Kimo Ilonen** është skulptor që jeton dhe punon në ishullin Norska-ta që gjendet në bregun jugperëndimor në Finlandë. Për veprat e tij, Ilonen shpesh përdor materiale natyrore. Për dragoin që e krijoi në Slloeshticë ka zgjedhur ahun – një dru tepër i rrallë dhe i vlerësuar në veri.
- **Sasho N. Alushevski** është fotograf, mik i “Art Point – Gumno”. Më së shumti hulumton fotografim skenik dhe portrete. Si mysafir në rezidencën artistike, ai krijon portrete të artistëve tjerë dhe krijon fotografi të autorëve.





- **Dik Roberts** është artist amerikan që rregullisht qëndron në Slloeshticë. Këtë vit, ai dhe Sergej Andreevski kanë kremtuar jubileun – 20 vite miqësi dhe krijim të përbashkët.

Rezidenca artistike ishte pjesërisht e mbështetur nga Ministria e Kulturës së RM-së.

2. Punëtori kreative në kuadër të projektit “Lidhja e personave me natyrën – përforsimi dhe rrjetëzimi i shoqatave qytetare në Maqedoni (27 shtator 2016)

Punëtorja u zhvillua në kuadër të fazës së tretë të projektit të mbështetur nga

Plantlife nga Britania e Madhe dhe Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës – IUCN, ndërsa në koordinim të Shoqatës Maqedonase Ekologjike – SHME. Rreth 15 nxënës të shkollës fillore komunale Braka Milladinovci në mentorim të artistëve ndërkombëtar – mysafirë të rezidencës së PAG kanë krijuar për nder të ahut dhe verit që janë më të përfaqësuar, si dhe për shkak të mungesës së informimit të popullatës lokale, drunjtë më të vlerësuar në rajonin e madh bimor Mali Ilinska dhe Pllakenska. Fëmijët kanë bërë distinktivë magnetike me thëngjill, kanë mbjellë ahe dhe kanë pikturuar tre pëlhura që do të zbkurojnë muret e komunës, shkollës së tyre dhe zyrës së SHME.

3. Pilot hulumtim të popullatës së gaforreve lumore të rajonit të Demir Hisarit të epërm (26 dhe 27 shtator 2016)

Anëtarët e “Art Point – Gumno” kanë qenë vullnetarë gjatë monitorimit të gaforres lumore (*Astacus astacus*) në rrjedhën e disa lumenjve, përfshirë edhe burimet dhe rrjedhën e Crna Reka. Monitorimi u zhvillua në kuadër të pilot projektit për identifikim të Natura 2000 në Maqedoni, ndërsa ka zbatuar një ekip i institutit për biologji pranë Fakultetit Matematiko-Natyror nga Shkupi.



4. Promovim i projektit “Aroma e ëndrrës” (dhjetor 2016)

“Aroma e ëndrrës” është projekt që ishte zbatuar me mbështetje simbolike të Ministrisë së Kulturës së RM, ndërsa është nga fusha e industrive kreative.

Qëllimi i pilot projektit është të promovohen dhe gjallërohen vlerat estetike tradicionale të artit popullor (inspiruar dhe/ose nxjerrë nga sendukët e nënave dhe gjysheve tona) në harmoni me mjekësinë popullore të bazuar në fuqinë magjike të bimëve nga pjesa jone. Janë prodhuar jastëk me dizajn unik dhe mbushje natyrore për aroma-terapi, si produkt praktik për përdorim të përditshëm që falë formulës së zgjedhur me kujdes (përzierje e bimëve) ka fuqi të largojë përdoruesin nga stresi dhe/ose të mundësojë gjumë të fortë dhe të qetë. Pritet ideja të zhvillohet më tutje dhe me anë të kësaj të hapen mundësi për biznes dhe mbështetje të tregut lokal të mjediseve rurale në komunën Demir Hisar dhe më gjerë.





Ditët e bletarisë maqedonase



Shoqata e bletarëve “Nektar” nga Manastiri prej 15 deri më 18 tetor 2015 në Shirok Sokak në Manastir, në mënyrë tradicionale për herën e tetëmbëdhjetë ka organizuar manifestimin kombëtar **“Ditët e Bletarisë Maqedonase”** në të cilën kanë marrë pjesë rreth tridhjetë prezantues nga Maqedonia. Vizitorët kanë pasur mundësinë personalisht të takohem me prodhuesit dhe të kërkojnë këshilla, të vendosin bashkëpunim mes tyre, të shkëmbejnë përvoja dhe të degustojnë ose blejnë produktet e ofruara nga bletët.

Me rastin e manifestimit, SHB “Nektar” ka shpallur një konkurs për nxënësit e shkollave fillore për përpunimin e veprave artistike dhe letrare në temën **“bletaria”**. Nga veprat e arritura (më tepër se treqind vepra), komisionet përkatëse profesionale kanë vendosur që të shpërblehen dhe gjatë mbylljes së manifestimit ju ishin shpërndarë

çmime, diploma dhe certifikata falënderimi.





Thirrje e tretë e Rrjetit për Zhvillim Rural për mbështetje të iniciativave të projektit

Me anë të Mekanizmit Projektues të Rrjetit për Zhvillim Rural, në shkurt të vitit 2016 ishte publikuar thirrja e tretë për mbështetje të iniciativave projektuese nga organizatat anëtare të RZR. Për zbatim të 7 iniciativave projektuese, RZR ka siguruar mbështetje financiare nga projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, në sajë të komponentit për përforsim të kapaciteteve.

Në periudhën nga maji deri nëntori, 14 anëtarë të Rrjetit për Zhvillim Rural, me anë të bashkëpunimit për partneritet kanë realizuar iniciativat vijuese të projekteve:

Emri i projektit: **Rruga magjike e prodhimit organik**

Bartës i aplikacionit: **Shoqata e prodhuesve të llojeve kopshtare dhe luleve HORTI EKO**

Partner: **Shoqata e fermerëve gra "AGRO - VINKA"**

Përmbledhje e shkurtë: Iniciativa ka pasur për qëllim të përmirësojë kushtet për zhvillim të bujqësisë organike në rajonin e Strumicës dhe Vinicës, si dhe të rritë vetëdijen tek prodhuesit bujqësor për mundësitë që ofron rajoni për zhvillimin e prodhimit organik. Me anë të trajnimeve në teren, më tepër se 160 aktorë, mes tyre edhe fermerë, përpunues dhe studentë, kanë qenë të njoftuar me praktikën e prodhimit organik me shtetet evropiane dhe kanë pasur mundësi të shkëmbe-



jnë njohuri dhe përvoja. Filmi edukativ që ishte përpunuar në bazë të hulumtimit paraprak të bërë për gjendjen e prodhimit organik dhe identifikimin e prodhuesve organik në rajonet e Strumicës dhe Vinicës, do të sigurojë qëndrueshmëri të aktiviteteve edhe pas përfundimit të kësaj iniciative të projektit. Video materiale do të kontribuojnë për ngritje të kapaciteteve të nxënësve në shkollat e mesme bujqësore dhe do të nxit shumë fermerë të kalojnë nga prodhimi konvencional në prodhim organik.



Emri i projektit: **Bëhu bletar!**

Bartës i aplikacionit: **Shoqata e fermerëve gra AGRO - VINKA**

Partner: **Shoqata për zhvillim, edukim dhe etikë ekologjike POLIMAT 13**

Përmbledhje e shkurtë: Dy shoqatat partnere me anë të kësaj iniciative të projektit kanë pasur për qëllim të afirmojnë potencialet për zhvillim të bletarisë në rajonin e Strumicës dhe Vinicës dhe të nxisin bashkëpunim mes aktorëve, si dhe shkëmbim të për-





vojave, njohurive dhe shkathtësive në fushën e bletarisë. Në sajë të projektit ishin organizuar vizita në teren në disa vende, ku bletarët fillestarë kanë pasur mundësi të mësojnë si të rrisin rendimentin dhe të zvogëlojnë rreziqet prej të cilëve rendimenti zvogëlohet dhe numri i komuniteteve prodhuese të bletëve. Si rezultat i takimeve të realizuar ishte realizuar bashkëpunim mes 20 kultivuesve potencial dhe aktiv të bletëve nga komunat Vinicë dhe Bogdanci.

Emri i projektit: **Specialitete tradicionale nga Malesheva**

Bartës i aplikacionit: **Shoqata – Qendra për bimë kuruese dhe fruta mali “Ambrozija”**

Partner: **Shoqata ekologjike “Solza”**

Përmbledhje e shkurtë: Qëllimi i dy organizatave partnere nga Pehçeva ishte me anë të kësaj iniciative të projektit të ndihmojnë në ruajtjen dhe pro-

movimin e specialiteteve tradicionale nga rajoni i Malishevës, që përfaqëson potencial për turizëm rural dhe përmirësim të cilësisë së jetës në këtë rajon. Me ndihmën e popullatës lokale, ishin mbledhur 30 receta të recetave tradicionale lokale dhe të paketuara në broshurë që ishte promovuar në etno panairin në Pavlovdën të Pehçevës. Në kuadër të aktiviteteve të projektit ishte organizuar trajnim për përgatitje të një pjese të specialiteteve lokale tradicionale në të cilën kanë marrë pjesë 15 gra nga Maleshevia dhe rajonit përreth.

Emri i projektit: **Edukim i prodhuesve bujqësor për mbrojtje të mjedisit jetësor nga përdorimi i tepërt i plehrave mineral dhe pesticide**

Bartës i aplikacionit: **Shoqata ekologjike Grashnica**

Partner: **Shoqata ekologjike ENHALON**

Përmbledhje e shkurtë: Në drejtim të mbrojtjes së ujërave të Liqenit të Ohrit dhe zvogëlimit të emisioneve të gazrave të dëmshme, në rajonin e Ohrit-Strugës ishin organizuar 2 trajnime për njohje me rregullat e praktikës së mirë bujqësore, që kanë përfshirë më tepër se 30 fermerë. Gjatë trajnimeve, ekspertët kanë shkëmbyer këshilla në lidhje me periodat kur duhet të shmanget hedhja e plehrit mbi tokën, mënyra e përdorimit të plehrave në fusha të pjerrtë, të tokë të ngopur me ujë, në afërsi të rrjedhave të ujit, procedura për përdorimin e plehrave dhe dozimi i tyre, etj. Për rritje të vetëdijes tek grupi më i gjerë i aktorëve ishte përpiluar një fletë edukative për praktikë të mirë bujqësore e lidhje me plehrat mineral.





Emri i projektit: **Edukim dhe mbështetje të bletarëve të rinj në rajonin e Strugës BLETARIA – BIZNIS FITIMPRURËS “**

Bartës i aplikacionit: **Shoqata qendër kreative RUBANKULT**

Partner: **Shoqata e bletarëve MATICA**

Përmbledhje e shkurtë: Projekti ishte realizuar me qëllim të edukimit dhe të jep mbështetje bletarëve fillestarë të rajonit të Strugës që kanë filluar pak para të merren me bletari, ose atyre që në perspektivë planifikojnë dhe kanë interes të veprojnë në këtë degë ekonomike. Rreth 30 fillestarë bletarë nga 8 vendbanime në rajonin e Strugës (Koroshishtë, Prisovjan, Zgraçan, Bërçevë, Tashmarunishtë, Lukovë dhe Modriç) ku ka parakushte natyrore për zhvillim të bletarisë, kanë marrë pjesë në punëtori në të cilën kanë mundur të mësojnë nga përvojat e ekspertëve dhe të fitojnë rekomandime të drejtpërdrejta. Teknika dhe fazat e procesit të bletarisë ishin paketuar në video material dhe broshurë, të cilat do të shërbejnë për informim dhe edukim të grupit më të gjerë të aktorëve.

Emri i projektit: **Mjedis jetësor më të mirë**

Bartës i aplikacionit: **Shoqata ekologjike “Kladenec”**



Partner: **Organizata e grave e Pehçevës**

Përmbledhje e shkurtë: Dy shoqatat partnere kanë nisur iniciativë për ngritjen e vetëdijes ekologjike tek të rinjtë në rajonin e Maleshevisë, si rajon që ka potencial të madh për zhvillim të eko turizmit rural. Për këtë qëllim, me anë të iniciativës së projektit, ata kanë organizuar trajnime për mbrojtje të natyrës dhe llojllojshmërisë biologjike, në dy shkolla fillore dhe një të mesme në Pehçevë dhe Berovë. Me anë të aktiviteteve të zbatuara, shoqata i ka nxitur të rinjtë në rajonin të bëhen më aktiv në mbrojtjen e natyrës dhe të ndryshojnë shprehitë e tyre shkatërruese ndaj natyrës.

Emri i projektit: **Zjarret malore dhe ndikimi i tyre mbi zhvillimin rural dhe ndryshimet klimatike**

Bartës i aplikacionit: **Shoqata nacionale e pronarëve privat të maleve**

Partner: **Qendra rajonale për përfaqësim**

Përmbledhje e shkurtë:

Nga e gjithë sipërfaqja malore e Maleshevisë, rreth 30% ju takon pronarëve privat të pyjeve dhe ka ndikim të madh mbi gjendjen ekonomike të personave nga ky rajon. Për të trajtuar rëndësie e ruajtjes së këtij resursi natyror në rajonin e Pehçevës dhe Berovës, dy organizatat lokale kanë nisur iniciativë për përforsim të vetëdijes publike për rrezikun nga zjarret malore dhe rëndësinë e tyre. Ishin organizuar punëtori në teren në të cilët ishin përfshirë pronar të rinj dhe privat të pyjeve me qëllim të informohen dhe të përfitojnë njohuri për parandalimin e zjarreve malore, rëndësinë e pyjeve në funksion të zhvillimit të biodiversitetit, lidhja e pyjeve me traditën e popullatës lokale, por edhe trendët moderne botërore gjegjësisht menaxhimin bashkëkohor dhe drejtim ime pyjet për të realizuar funksionin e tyre ekologjik, ekonomik, social dhe kulturor të zhvillimit rural.





9

Zhvillohet Kuvendi i Përgjithshëm i Rrjetit për Zhvillim Rural



Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM) më 2 dhjetor 2016 në hotelin 'Kontinental' në Shkup ka zhvilluar Kuvendin e gjashtë me rend në praninë e më tepër se 50 përfaqësues të 27 shoqatave, anëtare të RZR të RM.

Pas miratimit të rendit të ditës nga ana e të pranishmëve, Kryetari i RZR, Petar Gjorgjievski, ka pasur një prezantim të shkurtër hyrës duke përmendur që vitin e fundit Rrjeti ka punuar në shumë çështjeje, ndërsa më shumë në promovimin e masave për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi, në kuadër të projektit të USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike. Ai përmendi dy segmente të punës së Rrjetit si më të rëndësishme, dhe ato janë: Mekanizmi i Projektit me çfarë rritet niveli i përgjegjshmërisë, mes tjerash, në sajë të anëtarëve të Rrjetit dhe zyrës qendrore, si dhe ndaj përdoruesve të fundit dhe segmenti i



dytë, trajnime për shoqatat – anëtare me çfarë përforcohen kapacitetet e tyre dhe krijohen lidhje me të forta me mjedise lokale dhe rurale. Ai shtoi që në të ardhmen do të vazhdojë zbatimi i Mekanizmit të Projektit, duke u fokusuar në thirrjet për realizim të qëllimeve të përcaktuar në Strategjinë e Rrjetit.

Vesella Llambevaska Domazetova, kryetare e Bordit Drejtues të Rrjetit, a prezantuar aktivitetet e Rrjetit të zbatuar në periudhën mars 2015 – dhjetor 2016. Ajo paralajmëroi edhe aktivitete të ardhshme të planifikuara të Rrjetit, mes tjerash aktivitete të lidhura me themelimin e Komitetit Kombëtar për Bujqësi Familjare, proces që Rrjeti do të realizojë në bashkëpunim me FFRM dhe IZB (instituti për Zhvillim të Bashkësisë). Në Komitetin do të kenë mundësi të marrin pjesë gjithë shoqatat dhe fermerët e interesuar, me qëllim të mbahet dhe mirëmbahet bujqësia familjare në mjediset rurale dhe të mundësohet qëndrueshmëri me çfarë do të inkurajohen njerëzit të kthehen ose të mbeten në mjediset rurale. Ky proces është në fazën fillestare, andaj më tutje për detajet dhe aktivitete ka informuar Sreten Koceski, kryetari i IZB, me anë të prezantimit të tij.

Vëmendjen e të pranishmëve e mbajti prezantimi i Liljana Jonoski, koordinatore të Mekanizmit të Projektit, në të cilën ka theksuar përparësitë e përfitimeve të zbatimit të Mekanizmit të Projektit, si vegël për përmirësimin e punës me projekte dhe ngritje të kapaciteteve të Rrjetit. Duke marrë parasysh përvojën e deritanishme, ajo vendosi theksin mbi fushat e ndryshme dhe rajoneve në të cilat duhet të bëhet intervenim dhe përmirësim nga ana e shoqatave, me qëllim që në të ardhshme të realizohen mekanizma projekti më cilësor dhe me ndikim që do të kontribuojnë për zhvillimin e mjediseve rurale.





10

GLA – nga iniciativa lokale në koncept prijes për zhvillim të komuniteteve rurale

Më 4 nëntor, në Shtip, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM) ka organizuar ngjarjen “GLA – nga iniciativa lokale në koncept prijes për zhvillim të komuniteteve rurale” me qëllim të prezantojë 4 iniciativë për formim të Grupeve Lokale të Aksionit (GLA) të themeluar në përputhje me LEADER qasjen e BE-së. Me mbështetjen e projektit të USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, RZR i RM ka zbatuar një program të plotë për ngritjen e kapaciteteve në përputhje me veçoritë e LEADER qasjes së BE-së, duke përfshirë aktorë të sektorit publik, qytetar dhe afarist, nga 17 komuna të rajonit lindor dhe juglindor të Maqedonisë. Si rezultat i këtij procesi, katër GLA-të kanë përgatitur 4 Strategji për Zhvillim Lokal, duke inkorporuar aktivitete për përmirësimin e përfshirjes së gjithë aktorëve në procesin e marrjes së vendimeve për çështje me rëndësi për komunitetet e tyre rurale.

Në drejtimin e tij, Drejtori i Misionit të USAID, z. Xhejms Stajn, theksoi që “metodat që i përdorim për të mbrojtur komunitetet tona duhet të fokusohen në bashkëpunimin, integrimin, inovacionin dhe partneritetet. Duhet të përdorim qasje “nga poshtë-lartë” ku aktorët lokal do të krijojnë strategjinë dhe do të zgjedhin aksione, sepse ata janë më afër problemit dhe nga kjo vije zgjidhja. GLA-të janë thelbësore për sukses në zhvillimin lokal rural. Pikërisht kjo qasje “nga poshtë-lartë” i bashkon aktorët lokal në identifikimin e përbashkët të prioriteteve dhe projekte me të cilat do të arrihen rezultatet e preferuar në rajonet e tyre. GLA-të e udhëheqin zhvillimin lokal dhe janë në rend të parë për zbatimin e



programit për zhvillim lokal. Jam krenar që projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike përfshin qasje të plota dhe inovative si LEADER dhe themelimin e GLA-ve për të adresuar çështjen e rëndësishme siç është ndryshimet klimatike”.

Pas drejtimit të kryetarit të Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë (RZR e RM), z. Petar Gjorgjievski, drejtorit të Qendrës për Zhvillim të Rajonit Lindor Planifikues, z-nja Dragica Zdraveva dhe përfaqësuesi i Qendrës për Zhvillim të Rajonit Juglin-



dor të Planifikimit, z. Risto Çivçev, kanë vijuar prezantime të katër iniciativave për formim të GLA-ve.

“Kur flasim për Grupet Lokale të Aksionit dhe strategjive të tyre për zhvillim lokal, çdoherë i vendosim në kontekst të qasjes LEADER si bazë për zbatimin e mëtutjeshëm. Ajo që është më e rëndësishme për të përmendur është që nga fillimi i vitit 2015, qasja LEADER është pjesë e masave të reja të Programit IP-ARD 2 andaj pritjet e RZR-së janë madje më të mëdha pasi që Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit ka filluar procesin e përgatitjes së kësaj mase dhe është përgatitur që bashkë me anëtarësinë e vetë të kontribuojë me përvojën për të zbatuar programin. Në mënyrë partnere, RZR bashkëpunon me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit dhe autoritete tjera qeveritare në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe me subjekte relevante të sektorit



joqeveritar dhe afarist, për rritje të mëtutjeshme të kapacitetit të absorbimit të komuniteteve rurale për njohuri dhe përvoja të reja në lidhje me qasjen LEADER – theksoi z. Petar Gjorgievski në fjalimin e tij.

Në vitin 2014, në kuadër të projektit të USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, RZR ka realizuar partneritet me komunat e Strumicës, Vasilevës, Bosilevës dhe Novo Sellë, në rajonin juglindor, për adresim të masave për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, me anë të strategjisë rajonale të Grupit Lokal të Aksionit. Aktorët lokal ishin kyçur në themelimin e Grupit Lokal të Aksionit (GLA) si mekanizëm qendror dhe strukturë për menaxhim të zhvillimit rural në fushat synuese dhe në krijimin e Strategjisë për Zhvillim Lokal si dokument qendror me të cilën përcaktohen prioritetet dhe masat për zhvillim rural, me anë të shumë trajnimeve, udhëzimeve dhe metodave të trajnimit. RZR ka punuar me përbërësit e GLA-së (bashkësitë rurale, sektori afarist dhe joqeveritar) nga këto katër komuna me simulim të metodologjisë së qasjes LEADER dhe ishin zbatuar tre projekte të vogla për zhvillim rural me theks të aktiviteteve me adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi. Metodologjia e



LEADER, e pilotuar me anë të zbatimit të këtyre projekteve të vogla për zhvillim rural, u dëshmuar si një vegël efikase në nxitjen e përgjegjësisë tek aktorët rural në lidhje me çështjet e lidhura me ndryshimet klimatike.

Përvoja pozitive e përfituar në punën e këtyre komunave, ka shërbyer si bazë për zgjerimin e aktiviteteve në komuna tjera të rajonit lindor ose juglindor të planifikimit. Nga kjo, RZR ka zbatuar një proces për ngritjen e kapaciteteve në 17 komuna të rajonit lindor dhe juglindor të planifikimit, që ka rezultuar me nisjen e 4 grupeve lokale të aksionit: GLA Bjomija (territori i Gjevgjeliës, Bogdanci, Vallandovë dhe Dojran); GLA Pllaçkovica (territori i Shtip, Karbinci, Konçe dhe Radovish); GLA Bregalnica (territori i Probishtip, Makedonska Kamenica, Vinica, Koçani, Zrnovci dhe Çeshinovë-Obleshevë); dhe GLA Malesh-Pijanec (territori i Berovës, Pehçevës dhe Dellçevës).

RZR i RM-së ka rolin udhëheqës në afirmimin e LEADER BE në Maqedoni, si qasje inovative në kuadër të politikës për zhvillim rural në BE që ka për qëllim të stimulojë barazi dhe bashkësi për gjithë aktorët në proceset e krijimit të



politikave, marrjes së vendimeve dhe zbatimit të aktiviteteve lidhur me zhvillimin rural. Andaj, RZR, si organizatë lokale, do të vazhdojë edhe pas përfundimit të projektit, për të mbështetur iniciativat për formimin e GLA-ve dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomi të Ujit, në procesin e fillimit të LEADER BE si një masë e ardhshme IPARD në Maqedoni.





Rrjeti për Zhvillim Rural në Republikën e Maqedonisë Projekti i USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike

Tryezë e rrumbullakët:

“Ndikimi i ndryshimeve klimatike mbi bletarinë”

6 dhjetor 2016

Rrjeti për Zhvillim Rural në Republikën e Maqedonisë në kuadër të projektit të USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, në kërkesë të Lidhjes së Shoqatave Bletare të Republikës së Maqedonisë më 6 dhjetor në Shkup ka organizuar tryezë të rrumbullakët në temën “ndikimi i ndryshimeve klimatike mbi bletarinë”.

Në tryezën e rrumbullakët kanë marrë pjesë rreth 50 përfaqësues të shoqatave të kultivuesve të bletëve, anëtarë të Lidhjes së Shoqatave Bletare të Republikës së Maqedonisë.

Qëllim i ngjarjes ishte diskutim për gjendjen e sektorit të bletarisë në Republikën e Maqedonisë, si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Në fillim të tryezës, z-nja Ana Damovska, udhëheqëse e projektit të USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ka informuar të pranishmit për qëllimet e projektit dhe aktivitetet e deritanishme të projektit, si dhe aktivitetet e Rrjetit për Zhvillim Rural në Republikën e Maqedonisë.

z. Mende Trajkovski, Kryetar i Lidhjes së Shoqatave Bletare të Republikës së Maqedonisë u drejtua të pranishmëve duke prezantuar nevojën për organizim të punëtorisë si dhe për qëllimet e punëtorisë.

Në kuptimin e konceptit, ngjarja përbëhej nga dy pjesë:

- Prezantim për ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi bujqësinë me fokus të veçantë në bletarinë, ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi ushqimin e bletëve dhe paraqitjen e sëmundjeve të bletëve, dhe
- Diskutim me prezantim të përvojave të bletarëve dhe konkluzione dhe rekomandime.

Dr. Idena Xhimrevska theksoi që ndryshimet klimatike ndikojnë drejtpërdrejtë mbi biologjinë dhe filozofinë e bletëve, si dhe sjelljen e tyre, riprodhimin, ciklin e jetës.





Ndikimet indirekte të ndryshimeve klimatike janë: prishje të rrethinës natyrore në të cilën janë vendosur bletët, qasja në kullosa dhe ujë, paraqitja e sëmundjeve të bletëve, përdorimi i mjeteve për mbrojtje të bimëve si dhe pushtim dhe konkurrencë mes llojeve tjera ekologjike, raca dhe nën-lloje tjera.

Prof. Dr. Hrisulla Kiprijanovska nga Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqim në Shkup, theksoi që ndryshimet e veçorive të bimëve që sjellin mjaltë si rezultat i ndryshimeve klimatike manifestohen me: lëvizje të fenofazës së lulëzimit, shkurtim të fenofazës së lulëzimit (lulëzimit eksploziv), ndryshim të përbërjes së nektarit (dendësim) me çfarë vështirësohet kapja nga bletët, paraqitja e periudhave të gjata pa kullosa, ndryshime në prodhimtarinë e luleve, si dhe madhësia e luleve dhe hapja e tyre. Me këtë, bletët përballohen me mungesë të nektarit dhe polenit që janë të domosdoshme për zhvillimin dhe funksionimin e familjeve të bletëve.

Prof. Dr. Misho Hristovski nga Fakulteti për Mjekësi Veterinere në Shkup, me prezantimin e tij, u përqendrua në ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi paraqitjen e sëmundjeve dhe dëmtuesve tek bletët. Përveç sindromit koshere e zbrazët (Colony Collapse Disorder) që mes faktorëve tjerë është si rezultat i ndryshimeve klimatike, ndryshimet klimatike kanë ndikim dukuri në më të shpeshtë të murtajes amerikane të blerëve, varoza që bëhet më agresive dhe më rezistuese, paraqitja e nozemozëve dhe sëmundjeve me virus. Gjithashtu, ndryshimet klimatike ndikojnë edhe mbi paraqitjen e parazitëve të rinj dhe sëmundjeve parazitare siç janë: *Apocephalus borealis*, *Aethinia tumida*, *Tropilaelaps clareae*.






Si të zvogëloni efektet negative nga stresi i ngrohjes tek bagëtitë?

Në përputhje me rekomandimet e praktikave për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në fermë të prezantuar në Studimin për Adaptimin e Bagëtisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, projekti i USAID për adaptim të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike ka zbatuar masa afatshkurtër adaptive në nënsektorë të ndryshëm të bagëtisë si shpendaria, derra, lopë qumështore dhe regjim të adaptuar të ushqimit të lopëve në laktozë në kushte të stresit të ngrohtësisë. Për të mundësuar aktorët në blegtori të përfitojnë njohuri për përballim me ndryshimet klimatike dhe adaptim, projekti ka organizuar trajnime në teren në fermat e blegtorëve, përdorues të projektit, në të cilat ishin zbatuar dhe testuar masa të ndryshme adaptive.

Më 22 shtator, në fshatin Robovë, rajoni i Strumicës, 43 blegtorë dhe këshilltarë të ANZHB-së u mbledhën në një fermë me lopë në të cilën sisteme ftohjeje (ventilatorë dhe ajrosje) ishin instaluar për të zvogëluar efektin e stresit nga ngrohja tek lopët. Kontrollat e fermës të zhvilluar nga eksperti i projektit prof. Dr. Metodija Trancev, kanë treguar shenja pozitive gjatë muajve më të ngrohta të verës si rezultat i masave adaptive të zbatuar në këtë fermë.



Një grup tjetër prej 29 blegtorëve ishte mbledhur në një fermë pule në fshatin Kuçkovë, të rajonit të Shkupit, më 27 shtator. Atje, profesori Dr. Dragoslav Kocovski ka sqaruar efektet negative nga stresi i ngrohjes mbi cilësinë e vezëve dhe prodhimtarinë dhe intervenimet për luftimin kundër këtij stresit që ishin zbatuar, siç janë instalime të ventilimit dhe prezantimi i modifikimit të ushqimit. Në krahasim me rezultatin e periudhës së stresit nga ngrohja (fundi i qershorit, korrikut) kur të dhënat për prodhimtarinë e vezëve kishin regjistruar një ulje të prodhimtarisë si rezultat i temperaturave të rritura, të dhënat të marra gjatë muajit gusht kanë treguar shenja pozitive dhe trendë të përafërimit në vlera normale që ishin regjistruar para fillimit të temperaturave të larta.

Punëtorja më e madhe me prani ishte organizuar në rajonin e Sveti Nikollës më 30 shtator, në të cilën 72 fermerë dhe këshilltarë të ANZHB-së janë mbledhur për të mësuar masën adaptive për ushqim të lopëve qumështore dhe masat adaptive për ndryshim klimatik për përballimin e ngrohjes për derrat. Punëtorja ishte mbajtur në fermën e parë të fshatit Erxhelja dhe pastaj grupi ka vizituar një fermë derrash në fshatin Stanjevc.





Prezantimi i rezultateve të zbatimit të masave për adaptimi në blegtorisë ndaj ndryshimeve klimatike



Më tepër se 100 fermerë dhe këshilltarë të ANZHB-së (Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë), më 10 nëntor 2016, janë mbledhur në Sallën Biznes në Panairin e Shkupit, për të mësuar çfarë ndikimi kanë ndryshimet klimatike në blegtori dhe të mësojnë si të ruajnë prodhimtarinë. Projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, i zbatuar nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, kanë testuar masa për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në derrtarinë, shpendarinë dhe tek lopët qumështore. Rezultatet e fituara nga zbatimi i masave adaptive ishin shpërndarë me të pranishmit në ngjarjen me anë të prezantimeve të profesorëve nga Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqim, që në mënyrë intensive kanë punuar me blegtorët – përdorues të projektit, në zbatimin e këtyre masave të lehta dhe të gatshme dhe praktika adaptive.

Prof. Dr. Metodija Trajčev ka sqaruar pasojat negative nga valët e ngrohjes mbi nivelin e qumështit të lopëve dhe ka prezantuar rezultatet pozitive të fituara nga pesë fermat demonstrative në të cilët ishin instaluar sisteme

për ftohje. Prof. Dr. Srećko Gjorgjievski ka përshkruar ndikimet negative të ndryshimeve klimatike mbi ushqimin e kafshëve, që si pasojë kanë shkaktuar nivel të ultë të qumështit. Eksperti ka promovuar masat e testuar që kanë dhënë rezultate të shkëlqyeshme në uljen e këtyre pasojave të dëmshme. Një pjesë e masave përfshijnë: energji të zmadhuar të materies së thatë në kilogram, ulje të qimeve të papërpunuar, ndryshim i pjesshëm i misrit me sirak dhe kyçje të puferëve. Për ndikimin e temperaturave të larta në derrtari ka folur prof. Dr. Vlado Vuković. Mes tjerash, ai theksoi disa prej rezultateve pas instalimit të paneleve për ftohje në fermat synuese, si: ulje të zvogëlimit të konceptimit të ferrave në mesatarisht 10.8 në muaj, rritje të numrit të derrave të lindura për 0.1-0.3 derra për shtrat, ulje të nivelit të vdekjes gjatë laktacionit për rreth 5-8%, ulje të MMA (Mastitis, Metritis, Agalactia sindromin, etj.) në fund, vëmendjen e të pranishmëve ka mbajtur edhe prezantimi i Prof. Dr. Dragollav Kocovski, në të cilën kanë dhënë drejtime dhe rekomandime për të zvogëluar efektet negative të temperaturave të larta të verës, siç janë: numri i zvogëluar i vezëve dhe cilësia e zvogëluar e vezëve të prodhuar (lëvozhgë më të dobët dhe cilësi më të dobët të brendshëm të vezëve).

Projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ka shfrytëzuar këtë mundësi për të shpërndarë, tek palët e interesuara në blegtori, video materialin që jep rekomandime për zvogëlimin e pasojave të dëmshme nga ndryshimet klimatike mbi nivelin e qumështit të lopëve, në

derrtari dhe shpendari.

Kjo video paraprakisht ishte shpërndarë në internet faqen e RZR të RM-së (www.ruralnet.mk) si dhe kanal YouTube të RZR-së: <https://www.youtube.com/watch?v=6scQK6DVUr0&feature=share>





Mbyllje e projektit të USAID për adaptim të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike

Më 15 dhjetor 2016 në hotelin "Aleksandar Palace" në Shkup, projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike me ngjarje solemne i ka shënuar rezultatet e punës së suksesshme pesëvjeçare në prezantimin e masave adaptive të thjeshta dhe efektive i trajtojnë një problem të rëndësishëm siç është ndryshimet klimatike. Masat dhe teknikat e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike që ishin zbatuar në 28 fusha demonstruese dhe ferma, ju kanë ndihmuar fermerëve të përmirësojnë cilësinë e produkteve. Rezultatet e shkëlqyeshme të fituar nga praktikatat adaptive që ishin testuar në 6 module: pemëtari, vreshtari, kopshtari, humbje e dheut, kursim i ujit dhe blegtori, ishin përmbledhur në broshura, studime dhe video materiale, që kanë kontribuar për vetëdijen e rritur dhe njohuri tek sektori bujqësor në Maqedoni. Ky projekt ka rezultuar me rritje të numrit të fermerëve që përdorin masa adaptive siç janë: rrjete mbrojtëse UV në kopshtari, përdorimi i kërpuhës bamirëse për pirje më të madhe të ujit nga dheu, T-sistemi i krasitjes tek rrushi i tryezës dhe përdorimi i kalcium karbonatit në vreshtari, shortimi i shkurtë të fidanëve, etj.

Në fjalimin e tij, Drejtori i Misionit të USAID në Maqedoni, Xhejms Stajn, theksoi:

"Në Maqedoni pothuaj se gjysma e popullatës rurale është ekonomikisht e varur nga prodhimtaria bujqësore. Për të përgatitur për ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe të zvogëlojmë ndikimin e këtyre ndikimeve negative tek kulturat bujqësore, janë të



nevojshme masa praktike adaptive dhe aksione të shpejta lokale. Metodatat të cilat i përdorim për të mbrojtur komunitetet tona duhet të përqendrohen në bashkëpunim, integrim, inovacion dhe partneritet. Duhet të përdorim qasjen nga poshtë-lartë, ku aktorët lokal dizajnojnë strategjinë dhe zgjedhin aksione, sepse ata janë më afër problemit, dhe nga këtu edhe më afër zgjidhjes. Ju uroj Rrjetit për Zhvillim Rural që ka prezantuar masa pionere, inovative dhe të dobishme për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, për të ndihmuar fermerëve individual të ruajnë burimin e tyre të ekzistencës".

Drejtori i projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, z. Petar Gjorgievski, bashkë me ekspertin teknik të projektit, prof.

Dr. Dushko Mukaetov, fermerin dhe përfitues nga projekti, z-nja Vaska Mojsovska, përfaqësuesin e Grupit Lokal të Aksionit, z. Stole Gligorov, përfaqësuesin e Agjencisë për Nxitje të Zhvillimit të Bujqësisë (ANZHB), z. Savka Markudova dhe përfaqësues të Rrjetit për Zhvillim Rural, z-nja Liljana Jonoski, gjithashtu u drejtuan gjatë ngjarjes.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, si zbatues i projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, ka vendosur bashkëpunim formal me ANZHB-në, me qëllim të përmirësimit të kapacitetit të këshilltarëve bujqësor maqedonas, që do të kontribuojnë në zbatimin e praktikave bujqësore dhe do të sigurojnë qëndrueshmëri të aktiviteteve të projektit në kuptimin afatgjatë.



15

Organizohet Info Ditë për IPARD 2 – Masa 302

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, më 21 dhjetor 2016, në zyrat e Ministrisë, ka organizuar prezantim informativ për IPARD 2, masën “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”. Në ngjarjen, në të cilën kanë marrë pjesë pothuaj se 60 aplikantë të interesuar potencial, prezantime kanë zhvilluar përfaqësues të Sektorit IPARD, Agjencia për Mbështetjen Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe përdorues të projekteve të aprovuar dhe financuar nga kjo masë.







FROM THE AMERICAN PEOPLE



МРЕЖА ЗА РУРАЛЕН РАЗВОЈ
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА



ИПАРД

средства за мали бизниси
во рурални средини



МИНИСТЕРСТВО ЗА ЗЕМЈОДЕЛСТВО,
ШИМАРСТВО И ВОДОСТОПАНСТВО
на Република Македонија



IPARD - ЕВРОПСКИ МОЖНОСТИ ЗА
МАКЕДОНСКОТО ЗЕМЈОДЕЛСТВО



Shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale – 15 tetor

Ngjashëm me vitet tjera, Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së (RZR i RM) dhe Federata e Fermerëve e RM-së (FFRM), në mënyrë tradicionale kanë shënuar Ditën Ndërkombëtare e Gruas Rurale – 15 tetorin me manifestim që këtë herë u zhvillua në fshatin Mogilla, rrethina e Manastirit. Në ngjarjen kanë marrë pjesë rreth 120 gra nga vise të ndryshme rurale të Maqedonisë, por edhe përfaqësues të institucioneve shkenore, arsimore dhe tjera që bashkëpunojnë me popullatën rurale.


Para të pranishmëve u drejtuan, Lubisha Xhoniq, koordinatori kombëtar i Rrjetit të Grave – Fermerë e FFRM-së dhe Rankica Bozhinovska, përfaqësuese e shoqatës “Ferma Ime” – anëtare e Rrjetit për Zhvillim Rural, që kanë theksuar rëndësinë e rolit të grave në bujqësi dhe zhvillimit rural dhe kanë thirrur për aktivitet më të madh dhe kyçe në krijimin e politikave për bujqësi dhe zhvillim rural. Magdalena Gulevska, përfaqësuese e fondacionit “Elena Luka” dhe bashkëpunëtor lokal në projektin për dhënie bursave për nxënës të shkollave të mesme nga vi-

set rurale “Planifiko ardhmërinë tuaj” i ka prezantuar aktivitetet e fonacionit lidhur me mbështetjen e grave në viset rurale. Përshtypje ka lënë edhe drejtimi i përfaqësueses së Qendrës Strehimore, që i ka njoftuar të pranishmit me aktivitetet që i zbaton qendra.

Këtë herë ngjarja kishte karakter hu-

manitar dhe mjetet e mbledhura ishin dhënë Kryqit të Kuq të RM-së për ndihmë të personave të goditura nga vërshimet.

Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së, manifestimin e ka përmbajtur me anë të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike.





Panairi i tretë rajonal i vitit të ri të produkteve lokale në Nikshiq

Qendra e Inovacionit-Sipërmarrjes Tehnopolis dhe komuna e Nikshiqit, në periudhën 16-18 dhjetor 2016 në Qendrën Sportive në Nikshiq, kanë organizuar panairin e tretë rajonal të vitit të ri të produkteve lokale në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Malit të Zi dhe Grupit të Përhershëm për Zhvillim Rural të Evropës Juglindore (SWG RRD).

Qëllimi i këtij manifestimi që është me karakter shitës-ekspozues është nxitja, promovimi dhe mbështetja e prodhimit të produkteve tradicionale dhe punime dore, ku ekspozues të pjesëve të ndryshme të Malit të Zi dhe rajonit munde të ekspozojnë programin e tyre dhe të prezantojnë veprimtarinë e tyre, si dhe të vendosin bashkëpunim mes tyre.

Në panairin treditësh kanë marrë pjesë më tepër se 160 ekspozues, prej të cilëve 120 ishin nga Mali i Zi, ndërsa të tjerët nga vendet e rajonit si: Serbi, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni, Shqipëri dhe Slloveni. Nga Maqedonia, në panairin kanë marrë pjesë 11 prodhues lokal, përfaqësues të organizatave anëtare të Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë. Sipas vlerësimit të publikut, më interesante ishin stendat e Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Programin e hapi kryetari i Komunës Nikshiq, Veselin Gërboviq, që theksoi që ky manifestim mundëson një kontroll të drejtpërdrejtë të gjendjes së



mundësive për prodhim në komunën Nikshiq, por edhe në rajonet përreth, promovim të produkteve ushqimore, ushqim të shëndetshëm dhe veprimtari artizane-artistike, dhe njëherë paraqet një nxitje për qytetarët të blejnë produkte lokale. Me rëndësi të madhe është vendosja e kontakteve të reja, shkëmbimi i informacioneve dhe njohurive për trendët, si dhe mundësia për promovim të biznesit personal në mënyrë efektive.

Në sajë të panairit, ishin organizuar punëtori artistike për të rinjtë dhe tryezë e rrumbullakët në temën "Iniciativa për krijimin e platformës për ruajtjen dhe promovimin e produkteve tradicionale të Ballkanit Perëndimor në sajë të programit ABD të SWG RRD".





PREPARE Mbledhja 2016 dhe Kuvendi i Përgjithshëm u mbajtë në Voskopoje, Shqipëri

Këtë vit, PREPARE Mbledhja u zhvillua në Voskopje, Shqipëri, në periudhën prej 13 deri 16 shtator. Në këtë ngjarje katër ditëshe ka marrë pjesë edhe delegacioni maqedonas i përbërë nga dy përfaqësues të Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë, përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë të Ujit dhe një përfaqësues i shoqërisë qytetare FLORIT nga Gjevgjelia. Së bashku me tetëdhjetë përfaqësues tjetër të rreth 20 vendeve evropiane, u mbledhën me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe të mësojnë nga njëri-tjetri, të shtyrë nga qëllimi i përbashkët: të kontribuojnë për rrjetëzimin të zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Mbledhja ishte organizuar në kuadër të projektit ALTER, i zbatuar nga 9 partnerë, përfshirë edhe: Rrjetet për Zhvillim Rural të Serbisë (partneri udhëheqës), Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, Fondacioni për Zhvillim nga Turqia dhe dy bashkë-partnerë: Rrjeti Kroat për Zhvillim Rural dhe Forumi Rural i Letonisë si përfaqësues i PREPARE partneritetit për Evropë rurale. Grupi i përhershëm i punës për zhvillim rajonal rural i Evropës Juglindore është bashkëpunëtor formal i projektit. Projekti ALTER është fokusuar në përf forcimin e organizatave qytetare të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ky ishte takimi i parë tematik shumë kombëtar i organizuar nga ana e projektit me qëllim të sigurimit të dialogut intensiv me institucionet e Be-së dhe rrjetet e organizatave qytetare me përvojë relevante në kuadër të BE-së.

Pjesëmarrësit e PREPARE mbledhjes kanë pasur mundësi të vizitojnë prod-



hues dhe biznese lokale, fermerë dhe artizanë të rajonit të Korçës, gjatë Punëtorive në Rugë të organizuar më 14 shtator. Temat kryesore ishin diskutuar gjatë seancave plenare që do të mund të përmbidhen në dy pika kryesore:

- Përforcimi i kapacitetit të organizatave qytetare dhe rrjeteve të organizatave qytetare me qëllim të pjesëmarrjes aktive në planifikimin dhe zbatimin e politikave, të ndërtojnë shoqëri të fortë qytetare në mjediset rurale dhe të përmirësojnë zhvillimin rajonal me anë të rrjetëzimit dhe bashkëpunimit.
- Krijimi i partneriteteve mes organiza-



tave qytetare dhe rrjeteve të organizatave qytetare me institucionet publike dhe kyçja e tyre me aktive në proceset e vendimmarrjes dhe drejtimit, për mirëqenien e bashkësive rurale në këto vende.

Më 16 shtator u zhvillua Kuvendi i Përgjithshëm i PREPARE AISBL në praninë e 17 anëtarëve. Në kuvend ishte përcaktuar struktura organizative e PREPARE AISBL dhe ishin votuar koordinatorët kryesor dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv.

Si rezultat i votimit, kryetar i ri i PREPARE AISBL është Goran Shoster, nga Rrjeti Slloven për Zhvillim Rural. Aneli Kana, nga Lëvizja Estonieze e Fshatit "Kondukant" është zëvendës kryetar i parë, ndërsa zëvendës kryetari i dytë ishte zgjedhur Petar Gjorgievski nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë. Dragan Roganivog nga Rrjeti për Zhvillim Rural o Serbisë është Sekretari Gjeneral i ri ndërsa Anita Selicka nga Forumi Letonik Rural ishte zgjedhur si arkëtare e PREPARE AISBL.



19

Konferencë ndërkombëtare për përdorimin e masës për ndihmë teknike në përgatitjen e zbatimit të LEADER

Delegacioni i Maqedonisë i përbërë nga përfaqësues të Rrjetit për Zhvillim Rural i Maqedonisë, Organi Drejtues me IPARD në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit dhe Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kanë marrë pjesë në punëtorinë ndërkombëtare të synuar për shumë vende, dhe lidhur me përdorimin e masës për ndihmë teknike në përgatitjen e LEADER, që u zhvillua nga 15 deri 16 nëntor 2016, në Zagreb, Kroaci.

Punëtorja ishte fokusuar në aktivitetet fillestare të ngritjes së kapaciteteve që do të mund të financohen në kuadër të masës për ndihmë teknike, për të përgatitur zbatimin e ardhshëm të LEADER ("Lidhjet mes ekonomisë rurale dhe aktivitete zhvillimore"). Megjithatë shumë prej vendeve përdorues



të Instrumentit për Ndihmë Para-Aderimit (IPA) janë në fazën fillestare të formimit të Grupeve Lokale të Aksionit (GLA), por të interesuar për zbatimin e LEADER në një kohë, kjo punëtori ka



kryer një kontroll të punës që duhet të bëhet gjatë 2-3 viteve të ardhshme. Punëtorja ishte organizuar nga ana e Instrumentit për Ndihmë Teknike për Shkëmbim të Informacioneve të Komisionit Evropian.



Forumi rajonal “Nga ekonomi të qëndrueshme në shoqëri të qëndrueshme”

Më 23 dhe 24 shtator 2016 në Baranja, Kroaci, ishte zhvilluar forumi rajonal për zhvillim rural në temën “Nga ekonomi të qëndrueshme në shoqëri të qëndrueshme”. Forumi ishte organizuar nga Platforma për Zhvillim Rural e Evropës Juglindore që kanë për anëtarë: Rrjetin për Zhvillim Rural të Kroacisë – KRZR, Asociacioni për Zhvillim Kreativ – Sllap; Desha- Dubrovnik; Odras – Zhvillimi i Qëndrueshëm i Komunitetit; Shoqata për Zhvillim të Luginës Ibër “Ida”, Serbi; CERD – Qendra për Zhvillim Rural dhe Ekonomik, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë.

Përveç anëtarëve të Platformës, në ngjarjen kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Platformës për Ekonomi të Mirë, përfaqësues të Grupeve Lokale të Aksionit të Kroacisë, qytete, komuna dhe rajonale si dhe aktorë tjerë.

Në sajë të panelit të parë “Trendë dhe perspektivë”, përfaqësuesit e Platformës ju prezantuar të pranishmëve informacionet themelore për konceptin dhe zhvillimin e trendëve të ekonomisë së mirë, si dhe mundësinë për bashkim për shkak të qëndrueshmërisë financiare.



Pas përfundimit të pjesës teorike, paneli i dytë ishte dedikuar shembujve të praktikës së mirë. Vishnja Jelik Muk (Odras – Zhvillimi i Qëndrueshëm i Komunitetit) tregoi për GLA-të evropiane si shtytës të zhvillimit, ndërsa drejtori i banjave Sveti Martin në Mura, Branimir Blajiq, ka prezantuar modelin e tij të bashkëpunimit afarist me banjat që me sukses bashkëpunojnë me prodhuesit lokal. Shembuj tjerë të Evropës Juglindore ishin prezantuar nga anëtarët e Platformës: Petar Gjorgievski (Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë), Bojan Çikiq

(CERD – Qendra për Zhvillim Rural dhe Ekonomik) dhe Tomislav Kovačević (GLA Lika /RZRK).

Në kuadër të grupeve të punës ishte diskutuar për katër tema të ndryshme: (1) Modele të punësimit për të rinjtë në pjesët rurale, (2) Turizëm i qëndrueshëm rural, (3) Sipërmarrje sociale në mjediset rurale, (4) modele të shoqërimit afarist.

Në ditën e dytë, të pranishmit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në shumë aktivitete në kuadër të Panon Fest në fushën Baranje.